

TERMINOLOGJIA SI VEPRIMTARI NDËRDISIPLINORE DHE MUNDËSITË E BASHKËPUNIMIT TË ALB- SHKENCËS THE TERMINOLOGY AS INTERDISCIPLINARY ACTIVITIES AND OPPORTUNITIES FOR COOPERATION ALB-SCIENCE

EMIL LAFE

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, SHQIPËRI

Email: encikloped@yahoo.com

AKTET VI, 4: 347-351, 2013

PËRMBLEDHJE

Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë (Tiranë), ku ka qenë e përqendruar veprimtaria në këtë fushë, sot nuk e luan dot më rolin e mëparshëm. Ndërkaq detyrat që nxjerr praktika janë gjithnjë në rritje. Përpjekjet e viteve të fundit për organizimin e një veprimtarie të përbashkët të institucioneve të Shqipërisë e të Kosovës për terminologjinë nuk kanë dhënë ende frytet e pritshme. Ndërkaq çështjet e terminologjisë diskutohen gjithnjë e më shumë në veprimtaritë gjuhësore (sidomos nga profesorë të gjuhëve të huaja në universitetet shqiptare), por edhe ndërmjet anëtarëve të Alb-Shkencës, siç ishte rasti me gjetjen e barasvlerësit më të përshtatshëm shqip për stem cells. Nisur nga kjo, mendoj se seksionet e Alb-Shkencës mund të përfshijnë në veprimtarinë e tyre diskutime për çështje të terminologjisë së fushave përkatëse, duke kërkuar bashkëpunim edhe nga specialistë jashtë institutit. Përfundimet që dalin paraqesin rekomandime për zbatim. Në kumtesë propozohen disa forma pune për këtë veprimtari.

Fjalët çelës: terminologji, profesionalizëm, shkencore, ndërdisiplinore, gjuhësi, shqiptare, institut, letërsi.

SUMMARY

Institute of Linguistics and Literature (Tirana), where activity has been concentrated in this area, today did not play anymore previous role. However duties issues are growing practice. Efforts in recent years to the organization of a joint activity of Albania and Kosovo institutions have not yielded fruit terminology expected. Meanwhile terminology issues are discussed more and more language activities (especially foreign language professors in Albanian universities), but also between members of the Alb-Science, as was the case with finding suitable equivalents Classifieds for stem cells. Given this, I think sections of Alb-Science can include in their discussions on issues relevant fields terminology, seeking cooperation from specialists outside the institute. Conclusions arising paraqesinn recommendations for implementation. In the paper proposed some form of work for this event.

Key words: terminology, professional, scientific, interdisciplinary, Linguistics, Albanian, literary, institution.

1. Bashkëndimi i forcave akademike mbarëkombëtare

Rregullimi i terminologjisë përbën një veprimtari të vijueshme shkencore ndërdisiplinore. Ajo ecën krahas zhvillimit ekonomik e kulturor të një shoqërie dhe në kohët moderne është burim kryesor i pasurimit të leksikut kulturor të një gjuhe. Gjuhësia shqiptare ka fituar një

përvojë të mirë organizative e shkencore në këtë fushë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Tiranë), ku ka qenë e përqendruar veprimtaria për terminologjinë, sot nuk e luan dot më rolin e mëparshëm. Në vitet '70-'80 në këtë Institut ka pasur një sektor të veçantë të terminologjisë me shtatë punonjës; tani në sektorin e bashkuar të leksikologji-leksikografisë dhe

terminologjisë ka vetëm një anëtar për këtë fushë. Komisioni i Përhershëm për pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe (1979–1990) i dha nxitje punës për terminologjinë në gjithë sistemin e lartë arsimor dhe në institutet kërkimore-shkencore të Shqipërisë. Më 1980 në protokollin e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Tiranës dhe Universitetit të Prishtinës ishte përfshirë edhe ripunimi e plotësimi i fjalorëve terminologjikë të botuar deri atëherë, duke organizuar diskutime pranë katedrave përkatëse dhe me pjesëmarrjen e terminologëve të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë (Tiranë). Demonstratat e pranverës së vitit 1981 dhe represioni i Serbisë sollën ndërprerjen e plotë të bashkëpunimit deri atëherë të mbarë ndërmjet dy Universiteteve. Në kohët e fundit u bënë përpjekje për të gjallëruar bashkëpunimin në fushën e terminologjisë ndërmjet institucioneve të Shqipërisë dhe të Kosovës. Më 2003 u botua një fjalor shumëgjuhësh i emrave të bimëve¹, si bashkëpunim ndërmjet specialistëve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Një fjalor i termave të informatikës i botuar nga Qendra për Edukim dhe Përpajim në Prishtinë² është gjithashtu fryt i një bashkëpunimi të tillë. Më 2009 u mbajt në Tiranë konferenca shkencore me temë *Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe - Probleme e detyra*, e organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në

¹ Feriz Krasniqi, Babi Ruci, Jani Vangjeli, Latif R. Susuri, Alfred Mullaj, Qazim Pajazitaj: Fjalor i emrave të bimëve latinisht, shqip, anglisht, gjermanisht, frëngjisht/ Dictionary of Plant Names in Latin, Albanian, English, German and French. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kërkimeve Biologjike - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Shkencave të Natyrës. Tiranë – Prishtinë, 2003, 556 f.

² Lulëzim Shishani, Adelina Çerpja, Anila Çepani: *Fjalor i termave të informatikës* (Shqip-anglisht; Anglisht-shqip). Qendra për Edukim dhe Përpajim. Prishtinë, 2010, 703 f.

bashkëpunim me Qendrën e Studimeve Albanologjike në Tiranë dhe me institucione të tjera të shkencës e të arsimit të lartë³. Siç është njoftuar, në mars të këtij viti Këshilli Ndërrakademik për Gjuhën Shqipe mori në shqyrtim një parashtrësë për çështje të terminologjisë.

Në Shqipëri në fushën e terminologjisë jep ndihmesë të rëndësishme Drejtoria e Standardizimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, e cila përshtat në gjuhën shqipe fjalorët e përgatitur nga ISO (*International Standard Organization* – anëtare e së cilës është edhe Shqipëria), së bashku me standardet e objekteve. Një punë të madhe përballon edhe Drejtoria e Përkthimit pranë Ministrisë së Integritit, e cila përkthen në gjuhën shqipe legjislacionin e BE-së, që ka një vëllim prej rreth 100 mijë faqesh e mbulon 35 fusha me rreth 70 mijë terma. Sa është e bashkërenduar veprimtaria e institucioneve akademike me institucionet e administratës shtetërore, sa është e standardizuar terminologjia që përdoret, kjo është një çështje tjetër.

Nuk jam në dijeni nëse në Kosovë ka institucione të ngjashme që merren me terminologjinë në gjuhën shqipe ose bashkëpunojnë me institucionet e Shqipërisë. Për sa i takon Maqedonisë, nuk besoj se i ka ardhur radha këtij problemi.

2. Çka mund të bëjë Instituti Alb- Shkenca?

Terminologjia përbën një fushë pune ku kryqëzohen interesat shkencorë të disiplinave të ndryshme edhe kërkesat e gjuhësisë sonë për pasurimin dhe pastrimin e fjalorit të shqipes. Çështjet e terminologjisë diskutohen gjithnjë e më shumë në veprimtaritë gjuhësore (sidomos nga profesorë të gjuhëve të huaja në universitetet shqiptare), por edhe ndërmjet anëtarëve të Alb-Shkencës, siç ishte rasti me gjetjen e barasvlerësit më të përshtatshëm shqip për *stem cells*. Për këtë arsye mendoj se

³ Shih vëllimin: *Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe – probleme e detyra (konferencë shkencore)*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Tiranë, 2009, 296 f.

Alb-Shkenca mund ta bëjë terminologjinë veprimtari të përhershme të saj. Po çfarë mund të bëjmë ne, në ç'drejtim mund të jetë e dobishme puna dhe ndihmesa jonë. Këtë do të provoj të trajtoj në vijim.

Dihet se terminologjia ka aspektin konceptor dhe aspektin gjuhësor. Aspekti konceptor ka të bëjë me ndërtimin e sistemeve të koncepteve të një fushe të shkencës; aspekti gjuhësor me shënimin e këtyre koncepteve nëpërmjet fjalëve më të përshtatshme. Ndërtimi i sistemeve konceptore të një shkence është punë e specialistëve të asaj shkence (p.sh. është punë e gjuhëtarëve të ndërtojnë sistemet e klasifikimit të tingujve, të fjalëve, të fjalive etj.). Caktimi i shprehjes gjuhësore sa më të përshtatshme për këto koncepte është punë e përbashkët e gjuhëtarëve dhe e specialistëve të fushës përkatëse. Terma të veçantë shpesh krijohen nga studiues të ndryshëm, por terminologjia si sistem termash është përgjithësisht krijim kolektiv.

Kolegu ynë Nebi Caka në kumtesën e përgatitur me akad. Latif Susurin për Konferencën e terminologjisë të vitit 2009⁴ të përmendur më lart, kanë shpjeguar qartë se për sa i takon anës gjuhësore në terminologji dallohen dy procese: *standardizimi* dhe *normëzimi*. Standardizimi ka të bëjë me gjetjen e termit më të përshtatshëm (fjalë a togfjalësh) nga ana e kërkesave gjuhësore. Në terminologjinë e gjuhës shqipe si kërkesë themelore dhe e përhershme mbetet përparësia e fjalës shqipe ndaj fjalës së huaj. Kjo kërkesë është vënë në jetë duke gjetur fjalë të përshtatshme në leksikon e përgjithshëm të gjuhës për t'i "fisnikëruar" si terma ose duke krijuar fjalë të reja terma, shpesh sipas modeleve të gjuhëve të tjera. Normëzim në terminologji do të thotë që një sistem termash të një fushe të dhënë të marrë miratimin e një institucioni me autoritet shkencor e ligjor, pra të zyrtarizohet, të bëhet normë.

Mendoj se Alb-Shkenca mund dhe duhet të japë ndihmesën e saj në standardizimin e termi-

nologjisë së një vargu fushash që mbulojnë nëntë seksionet e saj: 1. Filologji, Histori, Kulturë; 2. Drejtësi; 3. Bujqësi; 4. Shkenca e Mjedisit; 5. Ekonomi; 6. Shkenca e Natyrës; 7. Mjekësi; 8. Inxhinieri e Teknologji e Informacionit; 9. Shkenca Shoqërore dhe Politike. Diskutimet për terminologjinë mund të bëhen një veprimtari e përhershme e Alb-Shkencës dhe temë diskutimesh në takimet tona vjetore. Kjo mund të arrihet me bashkëpunimin e anëtarëve të seksioneve të ndryshme me anëtarët gjuhëtarë të Alb-Shkencës, të cilët besoj se do të shtohen.

Dëshiroj të shtroj për diskutim në seksionin tonë një propozim: **të ngrihet një grup pune i përhershëm për terminologjinë**, që të nxitë e të organizojë diskutimet dhe të bashkërendojë punën. Besoj se z. Nebi Caka do të pranonte që të ishim së bashku në këtë grup dhe të mendonim edhe për një a dy të tjerë. Do të ishte e dobishme që në çdo seksion të ngarkohej një anëtar për të nxitur interesimin e seksionit ndaj çështjeve të terminologjisë, për t'i grumbulluar ato, sepse dihet që diskutimi është më i frytshëm, kur merret në shqyrtim një grup termash.

Sipas pikëpamjes sime, Alb-Shkenca nuk do të synojë të dyzojë punën e institucioneve të tjera. Ajo do të ndihmojë për gjallërimin e diskutimeve rreth terminologjisë dhe për përmirësimin e standardizimit të saj në këto drejtime kryesore:

- (a) në zëvendësimin e termave të huaj që janë në përdorim, me terma shqip të përshtatshëm;
- (b) në mënjanimin e sinonimisë;
- (c) në njësimin e terminologjisë që përdoret në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, veçanërisht në sistemin arsimor të të gjitha shkallëve;
- (ç) në gjetjen e zgjidhjeve sa më të përshtatshme për kërkesat e reja që mund të shfaqen, siç qe rasti i diskutimit për *stem cells*.

Alb-Shkenca nuk e ka tagrin e një institucioni normëzues. Por ne mund të japim **rekomandime normative** të argumentuara. Anëtarët e Alb-Shkencës në universitete e në institute kërkimore mund të ndikojnë që këto

⁴ Standardizimi dhe normëzimi i terminologjisë shkencore dhe profesionale, - shih *vep. cit.* në shënimin 3, f. 42-52.

rekomandime të merren parasysh, ose të nxitin diskutime për zgjidhje më të përshtatshme.

3. Cila është ndihma e IASH-së?

Krahas terminologjisë në kuptimin e ngushtë të fjalës, ka vend për të diskutuar edhe për ato që quhen fusha semantike të fjalorit. Në fjalorët ato shënohen me shkurtimin përkatës (*anat.* = anatomi, *fiz.* = fizikë etj.). Për strukturën e fushave semantike (ose strukturën terminologjike) të “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe” (1980; fjalorët e tjerë shpjegues të botuar pas tij kanë sjellë vetëm ndonjë përmirësim të pjesshëm) janë shkruar disa artikuj, sidomos nga prof. Flutura Çitaku e Universitetit të Prishtinës. Por në përgatitje për një fjalor të ri më të madh të gjuhës shqipe është mirë që këto fusha semantike të merren në shqyrtim një për një, të njihet për së afërmi çfarë kanë fjalorët dhe çfarë duhet shtuar.

Dy punime magjistrature të këtij viti në degën e gjuhës shqipe të Universitetit të Tiranës kanë pasur si objekt fushën kuzhinës e të gjellëtarisë dhe fushën e veshmbathjeve e të lëndëve që përdoren për to. Pas njohjes së lëndës që përmban fjalori, autorët do të hulumtojnë më gjerë këto fusha semantike në gjuhën e sotme.

Unë besoj se probleme kryesore të zhvillimit të gjuhës shqipe në ditët tona, ashtu si dhe për gjuhë të tjera, janë problemet e fjalorit dhe të terminologjisë. Specialistë të fushave të ndryshme, veçanërisht ata që kanë dashuri për fjalën shqipe dhe janë kërkues për një shprehje sa më të përpiktë gjuhësore, në studimet dhe librat e tyre krijojnë fjalë të reja, “fisnikërojnë” fjalë të zakonshme në përpjekje për ta bërë gjuhën shqipe të përputhshme me gjuhë të tjera të mëdha, sidomos me anglishten. Ndihtesat e tyre kanë nevojë për një shoshitje gjuhësore, në mënyrë që fjalët e përshtatshme të standardizohen e më pas të bëhen normë.

Vitet e fundit më ka rënë rasti të njihem me risitë gjuhësore të specialistëve të vreshtarisë dhe të verëtarisë, sidomos të prof. Andrea Shundit dhe bashkëpunëtorëve të tij. Këta jo vetëm kanë mbledhur me kujdes pasurinë e fjalëve të vreshtarisë e të verëtarisë kudo në trojet

shqiptare (përfshirë edhe ngulimet arbëreshe të Italisë e të Greqisë), por kanë krijuar vetë edhe një varg fjalësh të reja.

Fjalët *vreshtari* dhe *vreshtar*, që kanë mënjnuar fjalët e huaja *vitikulturë* e *vitikultor*, janë tashmë të njohura dhe janë përfshirë në fjalorët; sipas kësaj gjedheje ata kanë krijuar fjalët e reja *verëtari* dhe *verëtar*. A do t’i quajmë këto të mirëqena? A janë të pranueshme për gjuhëtarët dhe për specialistët e tjerë të kësaj dege të ekonomisë bujqësore? Kjo pyetje shtrohet edhe për një varg fjalësh të tjera të reja të botimeve të fundit për vreshtarinë dhe verëtarinë, si p.sh.: *erënim*, *flokëzim*, *fluskim*, *frytshmëri*, *gjerbim*, *lastarizon*, *lastarizim*, *lisnohet* (vera merr amësimin e drurit të lisit nga voza), *lisnim*, *mbushtore* (vendi ku mbushen shishet me verë), *moshim* dhe *pjekurim* (i verës), *motësim* (stazhionim), *ngjërues*, *ngjërime*, *pasore* (rimorkjo), *pezulli* (suspension), *përshenje*, *pështyrje*, *pjerrëtoje*, *pjerrëtim*, *puçërror*, *qimezon*, *qimezim*, *rruazon*, *rruazim*, *sythor*, *shihedhje*, *shishezim*, (lëndë) *shkojëzore*, *shkojëzim*, *shkumim*, *tapanxjerrëse*, *ujëdashës*, *urëzon*, *vreshtoj*, *vreshtim*.

Përveç këtyre fjalëve, që mund të quhen formime të reja, prof. A. Shundi dhe bashkëpunëtorët e tij, duke dashur të shfrytëzojnë sa më shumë fjalorin e shqipes, kanë rrëmuar e kanë kërkuar fjalë të përshtatshme për fushat e verëtarisë e vreshtarisë. Kështu p.sh. në FGjSSH (1980) fjala *amësim* shënohet si fjalë e leksikut poetik dhe shpjegohet “erë e këndshme”. Këtë fjalë e autorët tanë e kanë ngritur në term me kuptimin “Cilësi shqisore, erënim më se i këndshëm dhe i veçantë, që kryesisht përmbahet në lëvore të rrushit”.

Njohja e leksikut të fushave të caktuara semantike dhe e përpjekjeve të specialistëve për ta pasuruar atë duke u mbështetur kryesisht mbi brumin e shqipes, do të shërbejë për hartimin e një fjalori të ardhshëm të gjuhës shqipe (që të ketë të paktën dyfishin e fjalëve të FGjSSH) dhe për mënjanimin e fjalëve të huaja të panevojshme nga përdorimi. Po sjell dy shembuj: në FGjSSH mungon emërtimi “verë e thatë” (ka: *Verë e ëmbël*. *Verë e kuqe/e bardhë*).

Verë e vjetër/e re. Verë e gazuar). Në shtyp, kur flitet për konkurse verërash, përdoren fjalët e huaja *degustim, degustator*, kur mund të përdoren – me pak guxim në fillim – fjalët shqipe *ngjërim, ngjërues*, të përmendura më lart.

Shembulli i përpjekjes pozitive të specialistëve të kësaj fushe për të krijuar dhe përdorur një terminologji sa më shqipe dhe njëkohësisht të përpiktë, më shtyn të propozoj që në takimin e ardhshëm seksioni ynë në bashkëpunim me seksionin e bujqësisë, të organizojnë **një diskutim për çështje të terminologjisë së bujqësisë**. Dua të përmend se “Fjalori i termave themelorë të bujqësisë” (2006) i hartuar si bashkëpunim ndërmjet Institutit të Gjuhësisë e

të Letërsisë dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës ka kaluar pa ndonjë jehonë. Prandaj diskutimi mund të përqendrohet rreth këtij fjalori, por do t’u bëhet thirrje specialistëve të fushave të ndryshme të bujqësisë që të parashtrajnë paraprakisht për diskutim edhe “shqetësimet” e tyre terminologjike.

Diskutimet për terminologjinë dhe rekomandimet terminologjike janë të domosdoshme jo vetëm për mbarëvajtjen e zhvillimit të gjuhës shqipe, por edhe të shkencave në përgjithësi. Le të veprojmë edhe ne sipas një këshille të njohur: *“Bëj një herë të domosdoshmen, pastaj të mundshmen dhe papritur do të arrish të pamundshmen.”*.